



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 01/182  
Datë: 10.01.2024

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 10 janar 2024, merr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet Ekstrakti i Procesverbalit dhe Transkripti nga mbledhja e 178 e Qeverisë së Republikës së Kosovës.
2. Aprovohet Ekstrakti i Procesverbalit nga mbledhja e 177 elektronike/korresponduese të Qeverisë së Republikës së Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

Nr. 02/182  
Datë: 10.01.2024

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 15 të Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-111 dhe me Ligjin Nr. 05/L-009, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 10 janar 2024, merr këtë:

**V E N D I M**

1. Qeveria e Republikës së Kosovës për drejtorë të Bordit të Ndërmarrjes Publike Qendrore Hekurudhat e Kosovës, Train Kos Sh. A, emëron këta kandidatë:
  - 1.1. Z. Jetmir Nuka, kryesues;
  - 1.2. Znj. Vjollca Salihu, anëtare;
  - 1.3. Znj. Luljeta Lutfiu, anëtare;
  - 1.4. Z. Ruzhdi Zeqiri, anëtar;
  - 1.5. Znj. Kimete Fazliu, anëtare;
  - 1.6. Z. Afrim Bulluti, anëtar.
2. Të emëruarit nga pika 1. e këtij Vendimi kryejnë detyra dhe përgjegjësi në pajtim me Ligjin Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-111 dhe me Ligjin Nr. 05/L-009, dhe me dispozitat tjera ligjore në fuqi.
3. Mandati i të emëruarve nga pika 1. e këtij Vendimi zgjatë tre (3) vjet.
4. Me hyrjen në fuqi të këtij Vendimi, shfuqizohet Vendimi i Qeverisë Nr.15/138 i datës 12 prill 2023.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Albin KURTI**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

Nr. 03/182  
Datë: 10.01.2024

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 15 të Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-111 dhe me Ligjin Nr. 05/L-009, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 10 janar 2024, merr këtë:

**V E N D I M**

**Për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit të Qeverisë Nr. 09/81 të datës 1 qershor 2022**

1. Qeveria e Republikës së Kosovës për drejtor të Bordit të Ndërmarrjes Publike të Kompanisë Rajonale të Ujësjellësit K.R.U. Mitrovica Sh. A, Mitrovicë, emëron kandidaten si në vijim:
  - 1.1. Znj. Aurora Dinaj, anëtare.
2. Mandati i të emëruarës nga pika 1. e këtij Vendimi zgjatë sipas Vendimit të Qeverisë Nr. 09/81 të datës 1 qershor 2022, si pjesë përbërëse e këtij Vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Albin KURTI**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë





**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

Nr. 04/182  
Datë: 10.01.2024

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 3, 4, 7, 8, 44 dhe nenit 45 të Ligjit Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 10 janar 2024, merr këtë:


**V E N D I M**

1. Miratohet shqyrtimi i mëtejme i kërkesës së Komunës së Prizrenit për shpronësim për interes publik të pronës së paluajtshme Objekti i ish Ndërmarrjes Shoqërore "Liria" Prizren, që gjendet në parcelën kadastrale Nr.4792-0 pronë komunale, Zona Kadastrale Prizren, Komuna Prizren e cila është e nevojshme për realizimin e Projektit "Krijimi i hapësirave për lëvizshmërinë e trafikut dhe këmbësorëve" sipas tabelës bashkëngjitur këtij Vendimi.
2. Vlera e kompensimit të pronave do të caktohet nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, konform Ligjit Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205 dhe Udhëzimit Administrativ nr.02/2015 "Për zbatimin e metodave dhe kriterëve teknike të vlerësimit që do të përdoren për përllogaritjen e shumës së kompensimit për pronën e paluajtshme që shpronësohet dhe dëmeve që kanë të bëjnë me shpronësimin".
3. Brenda dhjetë (10) ditëve të punës pas miratimit të këtij Vendimi, Departamenti i Shpronësimit, konform nenit 8 paragrafi 8. të Ligjit Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, bënë shpalljen e Vendimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.
4. Kompensimi i pronës së shpronësuar dhe të gjitha obligimet tjera financiare dhe ligjore që mund të rrjedhin nga procesi i shpronësimit do të bëhet nga buxheti i Komunës së Prizrenit.
5. Për zbatimin e këtij Vendimi obligohen Departamenti i Shpronësimit (Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës), Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, Agjencia Kosovare e Privatizimit dhe Komuna e Prizrenit.



6. Vendimi hyn në fuqi në datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

Nr. 05/182  
Datë: 10.01.2024

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 4, 7, 8 dhe nenit 45 të Ligjit Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 10 janar 2024, merr këtë:


**V E N D I M**

1. Miratohet shqyrtimi i mëtejme i kërkesës për shpronësim për interes publik të pronës së paluajtshme e cila preket nga realizimi i Projektit: Konservimi dhe Restaurimi i Shtëpisë në Kompleksin Memorial "Masakra e Reçakut" Zona Kadastrale Reçak, Komuna e Shtimes, sipas tabelës bashkëngjitur këtij Vendimi.
2. Vlera e kompensimit të pronave do të caktohet nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve konform Ligjit Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205 dhe Udhëzimit Administrativ Nr.02/2015 "Për zbatimin e metodave dhe kritereve teknike të vlerësimit që do të përdoren për përlogaritjen e shumës së kompensimit për pronën e paluajtshme që shpronësohet dhe dëmeve që kanë të bëjnë me shpronësimin".
3. Brenda dhjetë (10) ditëve të punës pas miratimit të këtij Vendimi, Departamenti i Shpronësimit, konform nenit 8 paragrafi 8. të Ligjit Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, bënë shpalljen e Vendimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.
4. Kompensimi i pronave të shpronësuar dhe të gjitha obligimet tjera financiare dhe ligjore që mund të rrjedhin nga procesi i shpronësimit dhe vlerësimit do të bëhet nga buxheti i Subjekti Kërkues/Agjencia për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës.
5. Për zbatimin e këtij Vendimi obligohen Departamenti i Shpronësimit (Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës), Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve dhe Subjekti Kërkues/Agjencia për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës.



6. Vendimi hyn në fuqi në datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

Nr. 06/182  
Datë: 10.01.2024

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 29 të Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 03/L-221, me Ligjin Nr. 04/1-116, me Ligjin Nr. 04/L-194, me Ligjin Nr. 05/L-063, me Ligjin Nr. 05/L-007, të nenit 14, paragrafi 1. të Ligjit Nr. 08/L-260 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2024, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 10 janar 2024, merr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet kërkesa e Ministrisë së Drejtësisë për ndarje të mjeteve buxhetore në shumë prej 287,000 € (dyqindetëdhjeteshtatë mijë euro) për strehimoret dhe organizatat jo-qeveritare të licencuara të ofrojnë shërbime sociale dhe familjare, sipas Shtojcës 1. të këtij Vendimi.
2. Mjetet nga pika 1. e këtij Vendimi merren nga "Shpenzimet e Paparashikuara" me kod 232 nga nën-programi "Shpenzimet e Paparashikuara" me kod 13100, kategoria e shpenzimeve "Rezerva", dhe transferohen në Ministrinë e Drejtësisë me kod 215 në nën-programin "Shpenzimet Bazike për Strehimoret" me kod 01500, në kategorinë e shpenzimeve "Subvencione dhe Transfere".
3. Për mjetet financiare të shfrytëzuara nga pika 1. e këtij Vendimi, strehimoret dhe organizatat jo-qeveritare janë të obliguara të dorëzojnë raporte narrative dhe financiare në Departamentin për Shërbime Sociale dhe Mbrojtje të Fëmijëve dhe Divizionin për Buxhet dhe Financa në Ministrinë e Drejtësisë.
4. Obligohet Ministria e Financave Punës dhe Transfereve dhe Ministria e Drejtësisë për zbatimin e këtij Vendimi.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Albin KURTI**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



| <i>Nr.</i> | <i>Emri i subjektit juridik</i>                                                    | <i>Kohëzgjatja e projektit të OJQ për vitin 2023 nga buxheti i MD-së</i> | <i>Vlera dhe periudha e propozuar për Qeverinë për miratim të fondit emergjent për vitin 2024</i> |
|------------|------------------------------------------------------------------------------------|--------------------------------------------------------------------------|---------------------------------------------------------------------------------------------------|
| 1          | Shpresa dhe Shtëpitë e Fëmijëve Kosovë                                             | Maj - Dhjetor                                                            | 22,500.00, janar- prill 2024                                                                      |
| 2          | Qendra për Mirëqenien e Gruas                                                      | Maj - Shkurt                                                             | 8,750.00, mars- prill 2024                                                                        |
| 3          | Shtëpia e Sigurt                                                                   | Maj - Shkurt                                                             | 8,750.00, mars- prill 2024                                                                        |
| 4          | Asociacioni for Protection of Rights of Woman and Child - Liria - Gjilan           | Maj - Dhjetor                                                            | 20,000.00, janar- prill 2024                                                                      |
| 5          | Qendra për Mbrojtjen e Viktimave dhe Parandalimin e Trafikimit të Qenjeve Njerzore | Maj - Dhjetor                                                            | 20,000.00, janar- prill 2024                                                                      |
| 6          | Center for Protection of Women and Children                                        | Maj - Shkurt                                                             | 9,125.00, mars- prill 2024                                                                        |
| 7          | Qendra për Mbrojtjen e Grave dhe Fëmijve Shtëpia Ime - Ferizaj                     | Maj - Shkurt                                                             | 8,687.50, mars- prill 2024                                                                        |
| 8          | Qendra për Mbrojtjen e Gruas dhe Fëmijës - Raba Voca                               | Maj - Shkurt                                                             | 8,687.50, mars- prill 2024                                                                        |
| 9          | Qendra për Strehimin e Grave dhe Fëmijëve - Prizren                                | Maj - Shkurt                                                             | 8,625.00, mars- prill 2024                                                                        |
| 10         | Zenski Inkluzivni Centar                                                           | Maj - Shkurt                                                             | 7,625.00, mars- prill 2024                                                                        |
| 11         | SOS Fshatrat e Femijeve Kosove                                                     | Maj - Dhjetor                                                            | 7,500.00, janar- prill 2024                                                                       |
| 12         | Kosovo Humanitarian and Charitable Society - Mother Theresa, SHHBK                 | Maj - Shkurt                                                             | 3,750.00, mars- prill 2024                                                                        |
| 13         | Kosovar Catholic Church Caritas, C.I.K                                             | Maj - Dhjetor                                                            | 7,250.00, janar- prill 2024                                                                       |
| 14         | HANDIKOS - Suhareke, HK-SR                                                         | Maj - Dhjetor                                                            | 7,000.00, janar- prill 2024                                                                       |
| 15         | Shoqata e personave me aftesi te kufizuar, HANDIKOS -Drenas                        | Maj - Dhjetor                                                            | 6,750.00, janar- prill 2024                                                                       |
| 16         | Association of Paraplegic and Children Paralysis Persons of Kosovo, HANDIKOS       | Maj - Dhjetor                                                            | 6,750.00, janar- prill 2024                                                                       |
| 17         | QENDRA E KUJDESIT DITOR-PEMA                                                       | Maj - Dhjetor                                                            | 6,500.00, janar- prill 2024                                                                       |
| 18         | Independent Women's Association Hareja, Sh.P.G                                     | Maj - Dhjetor                                                            | 6,500.00, janar- prill 2024                                                                       |
| 19         | Organizata per femijet pa kujdes prindor, OFAP                                     | Maj - Dhjetor                                                            | 6,500.00, janar- prill 2024                                                                       |
| 20         | Shoqata e te Verberve te Kosoves - SH.V.K                                          | Maj - Dhjetor                                                            | 6,500.00, janar- prill 2024                                                                       |
| 21         | SHOQATA DOWN SYNDROME KOSOVA - DSK                                                 | Maj - Janar                                                              | 2,083.33, shkurt – prill 2024                                                                     |



|    |                                                                                                                |                |                               |
|----|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----------------|-------------------------------|
| 22 | Fondacioni Terre des hommes<br>Lausanne në Kosovë                                                              | Maj - Shkurt   | 3,125.00, mars- prill 2024    |
| 23 | Shoqata e femijeve dhe te rriturve<br>me aftesi te kufizuara,<br>HANDIKOS - Vushtrri                           | Maj - Dhjetor  | 6,250.00, janar- prill 2024   |
| 24 | Shoqata per Kujdesin Shtepiak te<br>te Semuarve "Duart Plote<br>Meshire", DPM                                  | Maj - Dhjetor  | 6,000.00, janar- prill 2024   |
| 25 | Small Development Business<br>Center of Kosovo, S.D.B.C                                                        | Maj - Janar    | 2,000.00, shkurt – prill 2024 |
| 26 | OJQ Princesha - Pejë                                                                                           | Maj - Dhjetor  | 6,000.00, janar- prill 2024   |
| 27 | Handikos - Gjilan                                                                                              | Maj - Dhjetor  | 5,750.00, janar- prill 2024   |
| 28 | Klubi Dëshira                                                                                                  | Maj - Dhjetor  | 5,500.00, janar- prill 2024   |
| 29 | Shoqata Carita Umbria                                                                                          | Maj - Shkurt   | 2,875.00, mars- prill 2024    |
| 30 | Udruzenje Zena - Povratnica Nas<br>Dom - Novo Brdo, UZP-ND                                                     | Maj - Dhjetor  | 5,750.00, janar- prill 2024   |
| 31 | Centar za Mir i Toleranciju<br>Pristina, CMTF                                                                  | Maj - Shkurt   | 2,750.00, mars- prill 2024    |
| 32 | Shoqata e personave me aftesi te<br>kufizuar HANDIFER                                                          | Maj – Dhjetor  | 5,500.00, janar- prill 2024   |
| 33 | Qendra per Perkrahejen e<br>Personave me Aftesi te Kufizuara<br>Mentale, Qendra per Jete te<br>Pavarur - Q.J.P | Maj – Dhjetor  | 5,500.00, janar- prill 2024   |
| 34 | HANDIKOS Peje, HK-PE                                                                                           | Maj - Shkurt   | 2,625.00, mars- prill 2024    |
| 35 | Shoqata e personave me aftesi te<br>kufizuar, Handikos Ferizaj,<br>Sh.P.A.K.-HK FR                             | Maj - Dhjetor  | 5,250.00, janar- prill 2024   |
| 36 | Shoqata e Personave me Paralizë<br>të Fëmijëve Handicap Kosova                                                 | Mars - Tetor   | 5,500.00, janar- prill 2024   |
| 37 | Qendra Kosovare per Vete-<br>Perkraheje, QKVP                                                                  | Maj - Shkurt   | 2,625.00, mars- prill 2024    |
| 38 | Shoqata e Paraplegjikve dhe e<br>paralizes se femijeve,<br>HANDIKOS - PRIZREN                                  | Maj - Janar    | 1,666.67, shkurt – prill 2024 |
| 39 | Public Organization for Local<br>Initiatives and Supports - Polis                                              | Maj - Dhjetor  | 5,000.00, janar- prill 2024   |
| 40 | Udruzenje Invalida HandiKOS<br>Ranilug                                                                         |                | 5,000.00, janar- prill 2024   |
| 41 | Keshilli Rinor Rahovecit KRR                                                                                   | Maj - Dhjetor  | 4,750.00, janar- prill 2024   |
| 42 | Asociacioni Nacional i Autizmit<br>në Kosovë                                                                   | Tetor - Shkurt | 2,500.00, mars- prill 2024    |
| 43 | HandiKOS-Gjakovë                                                                                               | Tetor - Shkurt | 2,000.00, mars- prill 2024    |
| 44 | AUTIZMI                                                                                                        | Tetor - Shkurt | 1,750.00, mars- prill 2024    |

|    |                                                                                            |                |                            |
|----|--------------------------------------------------------------------------------------------|----------------|----------------------------|
| 45 | Shoqata humanitare e prindërve me persona me aftësi të kufizuara mendore "Hadër" - Prizren | Tetor - Shkurt | 1,500.00, mars- prill 2024 |
|    |                                                                                            |                | 287,000.00                 |





**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

Nr. 07/182  
Datë: 10.01.2024

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 9 paragrafi 1.7. dhe nenit 15 paragrafi 3. të Ligjit Nr. 08/L-260 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2024, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 10 janar 2024, merr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet kërkesa e Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve për bartjen e mjeteve të pa shpenzuara nga viti 2023 në vitin 2024 të fondeve nga nën-programi "Kontigjenca për Energji" në shumë prej 22,738,482.51 € (njëzetedy milionë e shtatëqindetridhjetetë mijë e katërqindetetëdhjetedy euro e pesëdhjetenjë cent).
2. Mjetet sipas pikës 1. të këtij Vendimi barten në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve me kod 201, nën-programi "Kontigjenca për Energji" me kod 29050, kategoria e shpenzimeve "Subvencione dhe Transfere".
3. Obligohet Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve për zbatimin e këtij Vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Albin KURTI**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

Nr. 08/182  
Datë: 10.01.2024

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 15 paragrafi 3. të Ligjit Nr. 08/L-260 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2024, Vendimin e Qeverisë Nr. 29/112 të datës 13 dhjetor 2022, i ndryshuar dhe plotësuar me Vendimin Nr. 03/128 të datës 16 shkurt 2023, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 10 janar 2024, merr këtë:


**V E N D I M**

1. Aprovohet ndarja e mjeteve buxhetore në shumë prej 16,000,000 € (gjashtëmbëdhjetë milionë euro) për zbatimin e masës 1. dhe 4. të Planit të Veprimit për zbutjen e ndikimit të menjëhershëm socio-ekonomik të krizës energjetike sipas Vendimit të Qeverisë Nr. 29/112 të datës 13 dhjetor 2022, i ndryshuar dhe plotësuar me Vendimin e Qeverisë Nr. 03/128 të datës 16 shkurt 2023.
2. Mjetet e ndara sipas pikës 1. të këtij Vendimi merren nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve me kod 201, nga nën-programi "Kontigjenca për Energji" me kod 29050, nga kategoria e shpenzimeve "Subvencione dhe Transfere", dhe ndahen, si në vijim:
  - 2.1. Në Ministrinë e Financave Punës dhe Transfereve, ndahet shuma prej 11,000,000 €, në nën-programin "Ndihmat Sociale" me kod 00500, në kategorinë e shpenzimeve "Subvencione dhe Transfere", për zbatimin e masës 1. të Planit të Veprimit për zbutjen e ndikimit të menjëhershëm socio-ekonomik të krizës energjetike;
  - 2.2. Në Ministrinë e Ekonomisë me kod 213, ndahet shuma prej 5,000,000 €, në nën-programin "Administrata Qendrore" me kod 11313, kategoria e shpenzimeve "Subvencione dhe Transfere", për zbatimin e masës 4. të Planit të Veprimit për zbutjen e ndikimit të menjëhershëm socio-ekonomik të krizës energjetike.
3. Mjetet sipas këtij Vendimi transferohen, buxhetohen dhe alokohen në kodin e përcaktuar (00097) në programin përkatës.
4. Obligohet Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve dhe Ministria e Ekonomisë për zbatimin e këtij Vendimi.



5. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

Nr. 09/182  
Datë: 10.01.2024

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 7 paragrafi 5. të Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 10 janar 2024, merr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet propozimi për të kërkuar nga Presidentja e Republikës së Kosovës dhënien e autorizimit Ministrit të Mbrojtjes për nënshkrimin e Marrëveshjes Kornizë Ushtarake ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Republikës së Turqisë.
2. Rekomandohet Presidentja e Republikës së Kosovës për dhënien e autorizimit nënshkrimin e Marrëveshjes nga pika 1. e këtij Vendimi në pajtim me Ligjin Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Albin KURTI**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë